

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA Hana M. Radoniqi

**VENDI I THEKSIT BRENDË FJALËS NË GJUHËN
SHQIPE**

PUNIM I DOKTORATËS

Prishtinë, 2024

UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"
FACULTY OF PHILOLOGY

MA Hana M. Radoniqi

**THE PLACE OF WORD STRESS IN ALBANIAN
LANGUAGE**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2024

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA HANA M. RADONIQI

**VENDI I THEKSIT BRENDA FJALËS NË GJUHËN
SHQIPE**

PUNIM I DOKTORATËS

Mentori: Prof. dr. Bardh Rugova
Bashkëmentorja: Prof. dr. Aljula Jubani

Prishtinë, 2024

Përmbledhje

Ajo që e karakterizon theksin e shqipes është palëvizshmëria gjatë eptimit: cilado rrokje pasuese e temës është e parëndësishme për pozitën e theksit (Lowman 1932, Bevington 1974, Canalis 2007). Meqë mund të bjerë në rrokje të ndryshme, gjuhëtarët shqiptarë kanë arsyetuar se vendi i theksit në fjalët e shqipes nuk mund të paraqitet me një rregull të përgjithshme, duke lënë të kuptohet se rëndom, në të shquarën tek emrat, theksi bie në rrokjen parafundore (fusha, shoku), në pozicion parafundor edhe te mbiemrat (i mirë, e madhe, i thellë), te përemrat (e pacaktuar njëri, tjetër, tjerë; vetori unë; vetvetori vetë; pronorët ynë, jonë), te ndajfoljet (poshtë, prapë, ngrykë, përtokë), te numërorët (gjashtë, i parë), te pjesëzat (deri, mbase, ndoshta, pothuaj), te pasthirrat (falemnderit, tungjatjeta, lamtumirë, mirupafshim); kurse te foljet në pozicion fundor (punoj, ushqej), po ashtu edhe te parafjalët (nëpër, përmbi, përveç, përtej), te lidhëzat (porsa, sesa, kurse, meqenëse). Prandaj, edhe në huazimet nga gjuhë të ndryshme ky rregullohet sipas kësaj prirjeje: Dodi (1970, 2004), e ka konsideruar këtë si normë për shqipen letrare. Kurse se, lëvizja e theksit mund të paraqitet sipas rregullimit mekanik, Topalli (1995a, 1995b, 2001, 2005, 2011, 2012) ka dhënë një varg botimesh. Kolec Topalli ka paraqitur e përmbledhur çështjet historike të theksit të shqipes. Studimet monografike të tij janë shpeshuar pas viteve ‘80, në veçanti pas botimit të veprës “Theksi në gjuhën shqipe” (1995). Kapitulli mbështetet në trajtesat e autorit për lëvizjen e theksit të shqipes, e cila është quajtur *rregullim mekanik i theksit*. Për veçoritë dhe ritmet e ndryshimit të theksit do të bëhet edhe kategorizimi i prirjeve të shqipes – me elemente që janë zhdukur në stadin zhvillimor, që janë zëvendësuar dhe që janë krijuar e e karakterizojnë vetëm shqipen. Analiza e theksit të shqipes sipas pikëpamjeve të Topallit ndahet në dy pjesë: theksi i fjalës dhe i fjalisë. Prandaj, të gjitha teoritë tradicionale përfshihen te **Kapitulli I**.

Ndërsa, te **Kapitulli II** janë shfaqur veçoritë fizike të theksit në gjuhën shqipe. Zanorja e rrokjes së theksuar dallohet nga ato të rrokjeve të tjera të patheksuara nga gjatësia. Ajo është më e gjatë se zanoret e patheksuara. Kështu, theksi i shqipes nga natyra e vet fonetike nuk është thjesht një theks dinamik. Komponenti sasior, gjatësia, është tipar i domosdoshëm dhe themelor i realizimit të tij.

Te **Kapitulli III** dhe **IV**, gjuhëtarët e tjerë të huaj e kanë shpënë qasjen e theksit deri te rregullat, te fonologjia metrike, te Teoria e Optimalitetit (kufizimet) e te të tjera modele. Ky kapitull përfshin studimin bosht të trajtimeve të fonologjisë gjenerative të autorëve si, Chomsky-i dhe Halle-i (1968); studimin gjenerativ të fonologjisë së shqipes të Gary L.

Bevington-it (1974); punimet e John J. McCarthy-it (2002, 2003a, 2003b, 2007) për Teorinë e Optimalitetit, po ashtu edhe ato si bashkautor me Alan Prince-in (1993, 1995); punimin e Bruce Hayes-it (1989) për fonologjinë metrike; punimin e Jochen Trommer-it & Angela Grimm-it (2004) për theksin e shqipes e, tutje, me atë të Stefano Canalis-it (2007), Gjorgje Bozhoviqit (2012), Ricardo Bermúdez-Otero-it (2007, 2011), Bardh Rugovës (2006, 2016, 2019, 2020) etj. Qasja e këtyre autorëve se si e kanë përfaqësuar studimin e theksit në përgjithësi dhe, studimin në shqipen në veçanti, i ka tejkaluar paraqitjet tradicionale të vendosjes së tij në rrafshin e fjalës ose të rrokjes, duke u orientuar tashmë në traditën gjenerative.

Te **Kapitulli V** hetohet struktura e rrokjeve, numri i rrokjeve të hapura dhe të mbyllura në tërësinë e fjalëve që fillojnë me zanoren a, që fillojnë me bashkëtingëlloren b dhe me bashkëtingëlloren c, të renditura sipas fjalorit shpjegues e normativ “Fjalor i shqipes së sotme” (2002), për të parë nëse rënia e *ë*-së fundore e rrit numrin e rrokjeve të mbyllura ose, rastet kur shfaqet si marker fonologjik dhe morfologjik; ndarja e fjalëve në rrokje dhe përcaktimi i numrit të tyre (theksi në fjalët njërrrokëshe, dyrrrokëshe etj.); vendosja e theksit mbi rrokjen e caktuar; përqindja e fjalëve që nuk kanë theks, gjatësia dhe cilësia e zanores, skema e tingujve etj.

Parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është proklamuar si parim fonologjik: fjalët shkruhen ashtu si shqiptohen. Por, ndryshimet e dukurive drejtshkrimore karshi atyre drejtshqiptimore, posaçërisht pozicionet e zanores *ë* së patheksuar, si: *ë*-ja paratheksore, *ë*-ja pastheksore dhe *ë*-ja fundore nuk dëshmojnë barazi ndërmjet këtyre dy sistemeve parimesh të ndryshme. Kjo pasqyrohet te **Kapitulli VI**. Synim i këtij kapitulli është të hetojë shpërndarjen e tingujve në gjuhën shqipe, për të parë nëse përndarja tingullore korrespondon me përndarjen e shkronjave grafike në gjuhën e shkruar dhe, nëse drejtshkrimi e përcakton shqiptimin. Përndarja tingullore e varianteve shqiptimore midis folësve është transkriptuar sipas sistemit “International Phonetic Alphabet” (IPA). Gjatë interpretimit fonetik, në analizën e transkriptimit kanë dalë alternativa të ndryshme mes folësve, duke dalluar çifte fjalësh sipas gjatësisë, cilësisë së zanoreve etj. Prandaj, ajo që i përket thelbit të kapitullit është çështja e zanores *ë* së patheksuar në të tria pozicionet shqiptimore: *ë*-ja paratheksore, *ë*-ja pastheksore dhe *ë*-ja fundore, distribucioni i të cilave do të përfshijë raportet e llogaritura sasiore si dhe ndryshimet e tyre që marrin vlera të ndryshme, sipas dallimit të varianteve shqiptimore të folësve – dy shqiptarë nga Kosova dhe dy shqiptarë nga Shqipëria.

Së fundi, kuptimi teknik i termit *aksent* lidhet me mënyrën e shqiptimit. Qëllimi i **Kapitullit VII** është të përfshijë mënyrat e dallueshme të shqiptimit të fjalëve, veçanërisht të klasëve të ndryshme sociale. Diskutimi për këtë çështje mëton t’i bëjë bashkë disiplinat fqinje: në një rën anë sociolinguistikën (aksenti i huaj/ lokal ndërmjet folësve) dhe, në tjetrën, fonetikën

dhe fonologjinë (vendi i theksit gjatë shqyrtimit të rasteve kur hiqen tingujt/ rrokjet ose kur shtohen këto). Së këndejmi, statistikatat e përmbledhura bëhen të krahasueshme, meqë ndërmjet folësve ekzistojnë ndryshoret sociologjike: vendlindja, mosha, arsimimi, marrëdhëniet e pushtetit dhe të ndikimit etj. Pra, trajtohen ndryshimet që janë relevante nga aspekti sociolinguistik: nëse folësi përdor aksentin e tij lokal, si mjet për afirmimin e identitetit dhe të besnikërisë ndaj grupeve lokale – variacioni gjeografik. *Të dhënat dhe transkriptimi*: analiza e bisedës është incizuar në bazë të ndërveprimeve natyrore ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm, me qëllim të identifikimit të dukurisë së theksit në shqipen. Dallimi i ilustruar në transkripte thekson rëndësinë e kontekstit shoqëror: është përdorur transkriptimi fonemor sipas simboleve të IPA-s.

Resumé

What characterizes the stress of Albanian language is its immobility during flexion: any following syllable of the stem is irrelevant to the position of the stress (Lowman 1932, Bevington 1974, Canalis 2007). Since it can fall on different syllables, Albanian linguists have reasoned that the place of stress in Albanian words cannot be presented by a general rule, implying that usually, in the definite form in nouns, the stress falls on the penultimate syllable (fusha, shoku), in the penultimate position also in adjectives (i mirë, e madhe, i thellë), in pronouns (indeterminate njëri, tjetër, tjerë; personal pronoun unë; reflexive pronoun vetë; possessive pronouns ynë, jonë), in adverbs (poshtë, prapë, ngrykë, përtokë), in numerals (gjashtë, i parë), in particles (deri, mbase, ndoshta, pothuaj), in interjections (falemnderit, tungjatjeta, lamtumirë, mirupafshim); whereas in verbs in ultimate position (punoj, ushqej), and also in prepositions (nëpër, përmbi, përveç, përtej), in conjunctions (porsa, sesa, kurse, meqenëse). Therefore, also in borrowings from different languages it is regulated according to this tendency: Dodi (1970, 2004), has considered it as a standard for the literary Albanian language. Whereas that the movement of stress may be presented according to the mechanic regulation, Topalli (1995a, 1995b, 2001, 2005, 2011, 2012) has provided a series of publications. Kolec Topalli has presented and collected historical issues of Albanian stress. His monographic studies have become more frequent after the 80's, especially after the publication of the work "Theksi në gjuhën shqipe" (1995). The chapter is based on the treatises of the author on the movement of the Albanian stress, which is called *the mechanic regulation of the stress*. About the features and rhythms of the stress changes, it shall be done also the categorization of the tendencies of the Albanian – with elements that *have disappeared* in the development stage, that *have been replaced* and which *have been created* and are characteristic only for Albanian. The analysis of the stress of the Albanian language according to the viewpoints of Topalli is divided into two parts: the word stress and the sentence stress. Therefore, all the traditional theories are included in **Chapter I**.

On the other hand, **in Chapter II** the physical features of the stress in Albanian language have been presented. The vowel of a stressed syllable is distinguished from those of the other unstressed syllables by length. It is longer than the unstressed vowels. Thus, the stress of the Albanian language from its phonetic nature is not merely a dynamic stress. The quantitative component, the length, is a necessary and basic feature of its realisation.

In **Chapter III** and **IV**, the other foreign linguists have nailed the approach of the stress up to the rules, metrical phonology, to Optimality Theory (constraints) and to other models. This chapter includes the central study of generative phonology treatments of the authors like Chomsky and Halle (1968); the generative study of Albanian phonology of Gary L. Bevington (1974); papers of John J. McCarthy (2002, 2003a, 2003b, 2007) on the Optimality Theory, also the ones as co-author with Alan Prince (1993, 1995); the paper of Bruce Hayes (1989) on metrical phonology; the paper of Jochen Trommer & Angela Grimm (2004) on the Albanian stress and, further, with the one of Stefano Canalis (2007), of Gjorgje Bozhoviq (2012), of Ricardo Bermúdez-Otero (2007, 2011), of Bardh Rugova (2006, 2016, 2019, 2020) etc. The approach of these authors how they represented the study of stress in general and, the study in Albanian in special, has surpassed the traditional presentations of its placement on the ground of the word or of the syllable, already being oriented to the generative tradition.

In **Chapter V** it is observed the structure of syllables, the number of open and closed syllables in the totality of the words beginning with the vowel a, beginning with the consonant b and the consonant c, arranged according to explanatory and normative dictionary “Fjalor i shqipës së sotme” (2002), to see if the drop of the final *ë* increases the number of closed syllables or, the cases when it appears as a phonological and morphological marker; the division of words into syllables and the determination of their number (stress in monosyllabic, disyllabic words etc.); the placement of the stress on a specific syllable; the percentage of words without a stress, the quantity and quality of the vowel, the scheme of sounds etc.

The basic principle of the spelling of Albanian has been proclaimed as a phonological principle: the words are written the way they are pronounced. However, the changes of the orthographic phenomena compared to the orthoepic ones, especially the positions of the unstressed vowel *ë*, such as pretonic *ë*, posttonic *ë* and final *ë* do not prove an equality between these two systems of different principles. This is reflected in **Chapter VI**. The aim of this chapter is to investigate the distribution of sounds in the Albanian language, in order to see whether the distribution of sounds corresponds to the distribution of graphic letters in the written language and, whether the spelling determines the pronunciation. The distribution of sounds of pronunciation variants between the speakers has been transcribed according to the system “International Phonetic Alphabet” (IPA). During the phonetic interpretation, in the analysis of transcription, different alternatives among the speakers have emerged, distinguishing pairs of words according to the length, the quality of vowels etc. Therefore, what belongs to the essence of the chapter is the issue of the unstressed vowel *ë* in the three pronunciation positions: pretonic *ë*, posttonic *ë* and final *ë*, whose distribution will include the

calculated quantitative relations as well as their changes receiving different values, according to the distinction of the pronunciation variants of the speakers – two Albanians from Kosova and two Albanians from Albania.

Eventually, the technical meaning of the term *accent* is related to the way of pronunciation. The aim of **Chapter VII** is to include the distinct ways of pronunciation of words, especially of different social classes. The discussion about this issue tends to bring the neighbouring disciplines together: on the one hand Sociolinguistics (foreign/ local accent among speakers) and, on the other hand, the Phonetics and Phonology (the place of stress during the examination of cases when sounds/ syllables are omitted or when they are added). Thus, the summarized statistics become comparable, since there are sociological variables among speakers: place of birth, age, education, relations of power and influence etc. So, the changes that are relevant from the sociolinguistic aspect are addressed: if the speaker uses his local accent, as a means for the affirmation of identity and loyalty to local groups – geographical variation. *The data and transcription:* analysis of the conversation recorded based on natural interactions between different participants, with the purpose of identification of the phenomenon of stress in the Albanian language. The illustrated distinction in transcriptions emphasizes the importance of the social context: it is used the phonemic transcription according to the IPA symbols.